487
13,03,2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**
**DEKANATI**

Nr. 80 prot. Tiranë, më 13/03/2025

**Lënda :** Dërgohet lista e fituesve në programin e studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë në Arte Skenike" raundi i tretë për vitin akademik 2024 – 2025".

**Rektorit të Universitetit të Arteve**
**Prof. Dr. Erald BAKALLI**

Zoti Rektor,

Më datë 11/03/2025 Komisioni i Pranimit të aplikantëve konkurrentë në ciklin të tretë "Doktoratë në Arte Skenike" për vitin akademik 2024 – 2025 bëri vlerësimet e tij të raundit të tretë mbi bazën e dosjeve të paraqitura nga kandidatët në sekretarinë e FAS.

Vlerësimet e komisionit janë bërë bazuar në rregulloren "Për Programin e Studimeve të Ciklit të III për fitimin e Gradës Shkencor "Doktor" në Arte Skenike në programet e Studimit FAS pranë Njësisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni, në Universitetin e Arteve".

Në përfundim të këtij procesi po ju dërgoj listën e kandidatëve fitues të nxjerrë nga vlerësimi i Komisionit të Pranimit si dhe Vendimin Nr. 03 dhe 04. të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" në Arte Skenike dt. 12/03/2025, "Për shpalljen e fituesve të programit të doktoratës në Fakultetin e Artit Skenik për vitin 2024 – 2025"

Nisur nga sa më sipër, ju lutem, lista e fituesve duhet dërguar sa më parë në QSHA me qëllim pajisjen me numër matrikullimi në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Arte Skenike.

Lutem gjeni bashkëlidhur gjithë dokumentacionin shoqërues.

Ju faleminderit !

**DEKANI**

**Prof. Miltiadh KUTALI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE FAKULTETI I ARTIT SKENIK TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**
**DEKANI**

Nr. 487 prot. Tiranë, më 12 /03/2025

**V E N D I M NR 05.**

**Për shpalljen e vlerësimeve të Komisionit të Pranimit të kandidatëve konkurrues në studimet e doktoratës për vitin akademik 2024- 2025 në Fakultetin e Artit Skenik.**

Mbështetur në nenin 42 (Drejtuesi i Njësisë kryesore), të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", Neni 78, pika 2, Neni 79, pika 4 dhe 6; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23/2/2018, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", Kreu I; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.808, datë 11.12.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor"; Urdhërin e Ministrit të Arsimit nr. 127, datë 16.03.2022, "Për hapjen e Programit te Studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Arte Skenike" në Universitetin e Arteve të Tiranës; shkresën e MAS Nr. 3220/4 Prot., dt. 09/09/2024, "Mbi përcaktimin e kuotave të pranimit dhe udhëheqësve shkencorë për programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" për 2024-2025", në nenin 17 pikën 6 të rregullores "Për Programin e Studimeve të Ciklit të III për fitimin e Gradës Shkencor "Doktor" në Arte Skenike në programet e Studimit FAS pranë Njësisë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe Televizioni, në Universitetin e Arteve" miratuar me VSA nr. 33 dt. 17.11.2021, proces - verbalin e mbledhjes së Komisionit të Pranimit të kandidatëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2023 - 2024 në Fakultetin e Artit Skenik dt. 18/12/2024, si dhe Vendimin Nr. 03 të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" në Arte Skenike dt. 12/03/2025, "Për shpalljen e fituesve të programit të doktoratës në Fakultetin e Artit Skenik për vitin 2024 – 2025" :

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Komisioni i Pranimit të kandidatëve konkurrues në studimet e doktoratës për vitin akademik 2024 - 2025 në Fakultetin e Artit Skenik si dhe nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" në Arte Skenike,

**Vendosa**

1. Shpalljen e rezultateve të kandidatëve fitues dhe jofitues në procesin e konkurrimit për studimet e doktoratës për vitin akademik 2024 - 2025 në Fakultetin e Artit Skenik në rendin zbritës sipas listës më poshtë:

    1. I807140690 FITUES
    2. I460111171 FITUES

3. I75729060E JO FITUES
4. YB0512728 JO FITUES

2. Lista përfundimtare me kandidatët fitues, shpallet në mjediset e Fakultetit të Artit Skenik dhe faqen elektronike zyrtare të UART më datë 14/03/2025, si dhe regjistrimi i ftuesve të bëhet me datë 18.03.2025 duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Sekretaria Mësimore të marrë masa për njoftimin e kandidatëve konkurrues për rezultatet e konkursit.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Përgjegjësi i Njësisë Bazë Regji dhe Regji Filmi & TV dhe Sekretaria Mësimore e FAS. Në mbarim të procesit Sekretaria Mësimore e FAS të marrë masa për mbylljen e procesit të matrikullimit të kandidatëve fitues.

5. Një kopje e vendimit dërgohet pranë Rektoratit të UART.

**DEKAN**

**Prof. Miltiadh KUTALI**